

PROCESVERBAL – Tipi i kontrates - SHERBIM

**PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PER KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES:

“SHERBIMI I PASTRIMIT GRUMBULLIMIT DHETRANSPORTIT TE MBETURINAVE NE QYTETIN
MEMALIAJ DHE TRANSPORTIN E MBETURINAVE NE FSHAT MEMALIAJ ,LULEZIM, TOÇ,
QESARAT, ILIRAS DHE VASJAR(AGJENSIA LUFTINJE)

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV):

45452000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 7 002 400 (shtate milion e dymije e katerqind) lek pa TVSH

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Memaliaj ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

I. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

Ne ekstraktin historik te kete objekt te veprimtarise objektin e prokurimit pra sherbimin e pastrimit , grumbullim dhe transport te mbeturinave urbane, (sipas shtojcave)

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Shuma e sigurimit të ofertës është **140 048 (njqind e dyzete mije e dyzet e tete lek)** (shuma e shprehur me fjalë).

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme bazohen ne nenet 76, 82 dhe 83 te LPP, nenit 26, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet te dorezoje:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve (2019-2020-2021), të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport neativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për 3(tre) vitet e fundit (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën në një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.2.4 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2021 dhe 01. 06.2022 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Deklarate nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore per vitet 2021 dhe 01. 06.2022 sipas legjislacionit ne fuqi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

- **Argumentimi: Referuar nenit 43, pika 2, paragrafi c), dhe pika 3, pika 4, te VKM nr. 285 date 19.05.2021.**

3.3 Kapaciteti teknik.

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik ofertues duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

3.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera nga operatori ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon:

- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, shoqëruar me situacionet për shërbimet e kryera, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

➤ në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 1.2 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

3.3.2 Liçensat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:

3.3.3. Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licencat/lejet të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

Licença profesionale e kompanise ku te shoqerohet me diplomat e stafit teknik.

a.Licença profesionale e shoqërisë e vlefshme me kategorinë NP-12-A (Punime te inxhinjerise se mjedisit) sipas modelit te leshuar nga M.I.E. (MTI-MTPP).

a-Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per grumbullim dhe transportim i mbetjeve te llojeve te ndryshem (**Kodi III.2.B**).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat sa me sipër ne perputhje me perqindjen e pjesmarrjes ne sherbim).

3.3.4 Staf (personeli) kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës

a-Operatori Ekonomik duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik “Sherbimi i pastrimit grumbullimit dhe transportit te mbeturinave ne qytetin Memaliaj,dhe transportin e mbeturinave Fshat Memaliaj, Lulezim, Toç, Qesarat, Iliras dhe Vasjar (Agjensia Luftinje)” nëpërmjet një Deklarate nga ana e Administratorit të Shoqërisë.

b-Për stafin kryesor që është i punësuar pranë Operatorit Ekonomik të paraqiten kontratat e punës të vlefshme. Për ata ekspertë që nuk i përkasin drejtperdrejt operatorit ekonomik të paraqiten Deklarata e disponueshmërisë për ekzekutimin e kontratës.

c.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 10 (dhjete) punonjës të siguruar, duke përfshirë stafin e përhershëm per peridhen Tetor 2021 – Tetor 2022

d.Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore, për pagimin e sigurimeve shoqërore, të lëshuar për periudhën Tetor 2021 – Tetor 2022

e.Listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas ligjit, të shoqëruar me Formularet e Deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për secilin muaj, per periudhen Tetor 2021 – Tetor 2022

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

1.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, kapaciteti volumor 10 m³ jo më pak se 1 (një) copë;

2.Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, jo më pak se 1 (një) copë;

3.Makina për lagjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për lagjen dhe larjen e rrugëve pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, jo më pak se 1(nje) copë Të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

NR	LLOJI I MAKINERIVE	NJESIA	SASIA	PRONESI/QERA ETJ
1	Makine teknologjike grumbullues transportues jo me pak se 5 T	cop	1	Pronesi /qera
2	Makine teknologjike per fshirjen e rrugeve	cop	1	Pronesi /qera
3	Makine autobot per lagjen e rrugeve	cop	1	Pronesi /qera

Shënim: Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

- Makineri – pajisjet ne pronesi ose me qera shoqerohen me akt pronesie original ose kopje te noterizuar.Kontratrat e qerese te permbajne objektin dhe afatin e marrjes me qera te mjeteve (te vlefshme).
- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin (leje qarkullimi, Çertifikata pronesie. Gjithashtu, keto dokumenta te shoqerohen me te pakten 2 foto (ne te kater anet) te cdo mjeti qe ofrohet
- Operatorët ekonomikë, për të garantuar realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të paraqesë dokumentacion ligjor për disponimin e 63 kazanëve (kontieniere (ose duhet të paraqesë kontratë paraprake qiraje të kazanëve. Për të provuar këtë duhet të paraqitet kontrata e qerasë e vlefshme dhe e shoqëruar me dokumentacion justifikues të pronësisë së 63 kontinerëve të qiradhënsit.
-
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument që të vërtetojë se mjetet e propozuara janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.
- Deklaratë nga administratori i shoqërisë që mjetet e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.

Ofertuesit duhet te paraqesin ne oferte edhe dokumentacionin e meposhtem:

- Dokumentat qe lidhen me objektin e prokurimit (specifikimet teknike,metodologjia e punes,grafikun e sherbimeve).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

- Argumenti per piken 3.3: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 41, pika 4,(germa a,b,c,ç) pika 5 germa a,b,c te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave

te Prokurimit Publik”. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne se disponojne licencat profesionale per realizimn e sherbimit ,objekt i kontrates.,te leshuar nga autoritetet kopetente shteterore

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Ne seksionin e specifikimeve teknike, *njesia e prokurimit* vendosi te njejtat specifikime teknike dhe sasi e kerkesa te percaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike te dokumentuara ne Relacionin e perlllogaritjes se fondit limit.

Argumentimi: Gjate hartimit te specifikimeve teknike, Grupi i punes per hartimin e tyre, i eshte referuar parashikimeve te nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 40, pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Specifikimet teknike te hartuara per aparaturat mjekesore qe kerkohen te blihen, jane bazuar ne kerkesat e stafit mjekesor dhe cilesite e domosdoshme qe kerkohet te performoje aparati ne repartin ku do te vendoset si dhe standartet spitalore kombetare dhe nderkombetare.

Nepermjet kerkesave ndaj OE ofertues per te paraqitur certifikata ISO apo Certifikata/Deklarata Konformiteti CE etj te cilat aplikohen edhe ne komunitetin europian, behet e mundur qe te sigurohen nga aparaturat mjekesore parametra qe i pershtaten standarteve spitalore.

Permbajtja dhe qellimi i ligjeve dhe dispozitave administrative kane te bejne me sigurine, ruajtjen e shendetit te pacientit dhe perdoruesit te aparatures mjekesore si dhe me sigurimin e karakteristikave te kerkuara te performances se aparaturave mjekesore.

Gjate hartimit te specifikimeve teknike jane perdorur termat min, max, jo me i vogel, jo me i madh, ose ekuivalent etj, gje e cila stimulon konkurencen e OE por edhe ruan standartet e domosdoshme per te cilat kerkohet te blihet aparatura mjekesore.

NJP

Xhuvana Kuçi

Kristina Shqipe

Jamir Tabaku